



NË GLLOGJAN TË DEÇANIT MBAHET MANIFESTIMI QENDROR
NË 26-VJETORIN E "EPOPESË SË DUKAGJINIT"

NË 26-VJETORIN E 'EPOPESË SË DUKAGJINIT' BËHET THIRRJE QË KOSOVA MOS T'I FTOHË RAPORTET ME ALEATËT STRATEGJIKË



Në shënimin e 26-vjetorit të "Epopesë së Dukagjinit" u bë thirrje që Kosova mos t'i ftohë raportet me aleatët strategjikë si dhe që shqiptarët të jenë bashkë për ta çuar deri në fund amanetin e atyre që ranë për lirinë që gëzojmë sot.

Në "Epopenë e Dukagjinit" morën pjesë përfaqësues të partive politike opozitare, të niveleve lokale, veteranë të UÇK-së, përfaqësues nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Lugina e Preshevës, por jo edhe presidentja Vjosa Osmani dhe

kryeministri Albin Kurti, të cilët përmes "Facebook"-ut e kanë kujtuar këtë epope. Për dallim nga ta, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, me bashkëpunëtorë ka bërë homazhe në Glllogjan

AUTORITETET NË KOSOVË: ËSHTË AVANCUAR STATUSI I VENDIT NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË NATO-S F. 3



AGANI: SHQETËSUES LARGIMI I PROFESIONISTËVE SHËNDETËSORË F. 5



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net / www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shagiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



KATE DHE WILLIAM "THELLËSISHT TË PREKUR" NGA MBËSHTETJA E PUBLIKUT F. 2

KURTI: ME QEVERINË TONË FERMERI I KOSOVËS ËSHTË MË I PËRKRAHURI NË RAJON F. 6

KORCOK DHE PELLEGRINI VAZHDOJNË GARËN PËR PRESIDENT NË SLOVAKI F. 2

EKONOMI



RRETH 70 PËR QIND E BLERËSVE NË PATUNDSHMËRI VIJNË NGA DIASPORA F. 7

SENATI SHMANG SËRISH MBYLLJEN E QEVERISË AMERIKANE, MIRATON NJË PAKETË PËR SHPENZIME NË VLERË 1.2 TRILION DOLLARË F. 7

SPORT

YLLI ME FITORE TË RËNDËSISHME NË PRIZREN, VËLLAZNIMI RIKTHEHET NË VENDIN E PESTË F. 12



Kate dhe William “thellësisht të prekur” nga mbështetja e publikut

LONDËR, 24 MARS - Princesha e Uellsit, Kate dhe burri i saj, Princi William, janë shprehur “thellësisht të prekur” nga ngrohtësia e publikut dhe mbështetja e dhënë pas njoftimit për kancerin. Pas shumë javësh spekulime në rrjetet sociale për shëndetin dhe mirëqenien e saj, Kate ka thënë përmes një videomesazhi të premtën se i është nënshtruar kimioterapisë për kancer pas

një operimi që ka pasur në bark. Princesha 42-vjeçare ka thënë se informacioni për kancer e ka tronditur edhe atë, dhe se tani është në fazat e hershme të parandalimit. “Princi dhe Princesha janë thellësisht të prekur nga mesazhet e ngrohta prej njerëzve në Mbretërinë e Bashkuar, nëpër Komonuelth dhe në gjithë botën”, është thënë në një deklaratë të lëshuar prej Pallatit

Kensington. “Ata janë të prekur prej mbështetjes dhe janë mirënjohës për mirëkuptimin ndaj kërkesës së tyre për privatësi”. Presidenti amerikan Joe Biden dhe Mbreti britanik Charles III kanë qenë vetëm disa prej figurave të larta që kanë ofruar mbështetjen e tyre për Princeshën. Kate nuk ka treguar për llojin e kancerit që ka edhe as fazën në të cilën është duke u trajtuar.



Korcok dhe Pellegrini vazhdojnë garën për president në Sllovaki

BRATISLAVË, 24 MARS - Rezultatet përfundimtare të raundit të parë të zgjedhjeve presidenciale në Sllovaki kanë treguar që ish-ministri i Jashtëm Ivan Korcok është në krye të garës. Korcok, liberal, udhëheq me 42.5 për qind të votave, sipas rezultateve zyrtare të publikuara prej Komisionit Zgjedhor të dielën. Ai do të garojë tani me kryetarin e Parlamentit të Sllovakisë, Peter Pellegrini, në rrethin e dytë të zgjedhjeve, më 6 prill, pasi

asnjëri kandidat nuk e ka fituar shumicën. Pellegrini i ka fituar 37 për qind të votave, pavarësisht se në sondazhet para zgjedhjeve janë përmendur shifra më të mëdha. Dalja në zgjedhjet e së shtunës ka qenë 51.9 për qind. Partia e Pellegrinit është pjesë e koalicionit qeverisës në qeverinë e krahut të majtë të kryeministrit Robert Fico. Partia populliste e krahut të djathtë, Partia Kombëtare Sllovaqe, është, po ashtu, pjesë e

koalicionit. Korcok përkrahet prej opozitës. Presidentja aktuale Zuzana Caputova nuk ka garuar për një mandat të dytë pesëvjeçar pavarësisht prej popullaritetit që gëzon. Në garë për president kanë qenë nëntë burra. Në debate kanë mbizotëruar temat e luftës në Ukrainë dhe mospajtimet e brendshme mes udhëheqësish të Ficos dhe opozitës liberale, pasi aktualisht Sllovakia është thellësisht e ndarë në pozicionimet politike.



Raketat ruse godasin Kievin për herë të tretë në katër ditë

KIEV, 24 MARS - Raketat ruse e kanë goditur kryeqytetin ukrainas, Kievin, në orët e para të 24 marsit, çka përbën sulmin e tretë “masiv” në këtë qytet në katër ditët e fundit. Serhiy Popko, udhëheqës i administratës ushtarake të Kievit, ka thënë në platformën Telegram se aktualisht nuk ka raportime për viktima. Sulmet në kryeqytet kanë zgjatur rreth dy orë. Raketat ruse e kanë goditur edhe rajonin perëndimor të Lvivit, duke nxitur Poloninë, vend anëtar i NATO-s, që ta rrisë alarmin për mbrojtjen ajrore. Varshava ka raportuar që një raketë e ka shkelur hapësirën



ajrore shtetërore afër qytezës Oserdov. Kryetari i Lvivit, Andriy Sadovyi, ka thënë në Telegram se asnjëra prej raketave nuk e ka goditur

qytetin, ndonëse e kanë pasur cak “infrastrukturën kritike”. Forca ajrore ukrainase ka raportuar se 18 prej 28 raketave dhe 25 prej 28 sulmeve me

dronë janë bllokuar. Ndërkohë, zëvendësministria e Energjisë, Svitlana Grynychuk, ka thënë më 23 mars që më shumë se 1 milion ukrainas kanë mbetur pa energji elektrike si pasojë e sulmeve ruse në rrjetin elektrik më 22 dhe 23 mars. “E kemi kuptuar që objektivi i tyre kryesor është sistemi energjetik”, ka thënë Grynychuk. “Sulmi i tyre një ditë më parë ka qenë ndoshta më i madhi që prej nisjes së luftës”, në shkurt të vitit 2022. Më shumë se 250 000 njerëz është raportuar të kenë mbetur pa energji elektrike vetëm në rajonin e Harkivit. Sulmi i fundit ka ndodhur pak

orë pas sulmit të së premtes në një sallë koncertesh në periferi të Moskës, duke lënë 133 persona të vdekur. Përgjegjësinë për sulmin e ka marrë grupi ekstremist Shteti Islamik, duke thënë se ka kryer sulm të madh kundër “të krishterëve”. Zyrtarët amerikanë e kanë konfirmuar vërtetësinë e deklaratës së grupit. Presidenti rus Vladimir Putin dhe zyrtarë të tjerë të Rusisë sugjerojnë - pa ofruar dëshmi - se Ukraina ka qenë e përfshirë në sulm. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky e ka mohuar çfarëdo lidhje me sulmin.

Kidnapuesit lirojnë mbi 280 nxënës nigerianë

KURIGA, 24 MARS - Më shumë se 280 nxënës të kidnapuar nga disa sulmues të armatosur në veriperëndim të Nigerisë, më herët gjatë këtij muaji, janë liruuar të dielën dhe atyre nuk është shkaktuar ndonjë dëm, kanë thënë zyrtarë shtetërorë dhe ata ushtarakë. Kidnapimet në Kuriga dhe Kaduna, më 7 mars, kanë qenë ndër më të mëdhatë në

vitet e fundit dhe kanë nxitur zemërim kombëtar si dhe ndjenjën e pasigurisë. Mësuesit dhe banorët patën thënë që rreth 280 nxënës janë kidnapuar, ndërsa ushtria ka thënë fillimisht se 137 nxënës janë liruuar. “Pëngjet e liruara, 137, janë 76 vajza dhe 61 djem. Ata janë shpëtuar në shtetin Zamfara dhe do t'i dorëzohen

Qeverisë në Kaduna për veprime të mëtejme”, ka thënë zëdhënësi ushtarak Edward Buba. Më vonë janë liruuar edhe nxënës të tjerë. Mediet kanë thënë se nxënës të kidnapuar janë të moshës prej tetë deri në 15 vjeç. Bandat e kriminelëve janë fajësuar për kidnapimet.



25 vjet nga sulmet ajrore të NATO-s kundër caqeve serbe, Kosova falënderuese



Fillimi i bombardimeve të NATO-s më 24 mars 1999 mbi caqet ushtarake dhe policore pushtuese serbe shënon datën e ndritur që përbashkon Prekazin, Reçakun, luftën çlirimtare të UÇK-së dhe NATO-n. Kështu kanë vlerësuar përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës të dielën me rastin e 25-vjetorit të fillimit të sulmeve ajrore të NATO-s kundër caqeve serbe

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka përshkruar 24 marsin e vitit 1999 si ditë të shpresës së madhe për Kosovën, teksa ka rikujtuar nisjen e bombardimeve të NATO-s mbi caqet policore dhe ushtarake në ish-Jugosllavi. “Njëzet e katër marsi ishte vërtet ditë e shpresës së madhe, sepse për herë të parë aleancat e botës demokratike u bënë bashkë për ta parandaluar shfarosjen e popullit të Kosovës nga regjimi i atëhershëm gjenocidal i [ish-liderit, Slllobodan] Millosheviq, dhe së bashku me shumë e shumë shtete të tjera partnere arritëm që Kosova më në fund të bëhet e lirë”.

Ajo i ka bërë këto deklarata pasi ka kryer homazhe te memoriali i ushtarëve të rënë të NATO-s për lirinë e Kosovës, i cili gjendet në sheshin “Nëna Terezë” në Prishtinë. Të pranishëm kanë qenë edhe ambasadorë të vendeve perëndimore në Kosovë. “Kjo ditë e shpresës së madhe është shndërruar në një partneritet të palëkundur ndërmjet Kosovës dhe botës demokratike, aleanca që edhe sot vazhdojnë”, tha ajo.

Osmani e ka falënderuar secilin ushtar të NATO-s që, siç ka thënë ajo, e ka rrezikuar jetën “në mënyrë që ta shpëtojnë tonën”. “Dua t’i falënderoj të gjithë liderët e botës demokratike që nuk i mbyllën sytë para vuajtjeve të popullit të Kosovës, por na dolën zot, na erdhën në shpëtim dhe edhe sot qëndrojnë pranë nesh, përderisa punojmë bashkërisht që Kosova e sotme të jetë Kosovë që do t’i bëjë jo vetëm qytetarët, por edhe miqtë

e saj, që të mburren me sukseset në zhvillimin e demokracisë”, ka deklaruar Osmani.

Ambasadori i ShBA-së në Prishtinë, Jeff Hovenier, ka thënë se sot nderojnë pjesëtarët e guximshëm që bënë sakrificë të madhe. “Sot u bashkova me presidenten Vjosa Osmani në memorialin për ushtarët e rënë të NATO-s. Ne kujtojmë dhe nderojmë ushtarët e guximshëm të cilët bënë sakrificën më të madhe, përfshirë Oficerët e Lartë të Armatës së Shteteve të Bashkuara, David Gibbs dhe Kevin Reichert”, ka shkruar Hovenier në “X”.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se fillimi i bombardimeve të NATO-s më 24 mars 1999 mbi caqet

ushtarake dhe policore pushtuese serbe, shënon datën e ndritur që përbashkon Prekazin, Reçakun, luftën çlirimtare të UÇK-së dhe NATO-n. “Me ndërhyrjen e NATO-s luftës sonë çlirimtare iu njoh zyrtarisht karakteri universal si luftë për mbrojtjen e vlerave të lirisë, jetës, demokracisë, dinjitetit, të drejtave të njeriut dhe të popujve. Kjo datë ka protagonistët e saj, me presidentin Bill Clinton, sekretaren e shtetit Madeleine Albright dhe gjeneralin Wesley Clark, ShBA-në dhe të gjithë shtetet mike brenda aleancës së NATO-s, mirënjohja ndaj të cilëve është e pamatshme, rëndësia e të cilëve është e pazëvendësueshme. Republika e

Kosovës ka në themelet e saj sakrificën dhe përpjekjen e popullit tonë për liri, heronjtë, dëshmorët dhe martirët, por edhe këtë akt historik të NATO-s, i cili për herë të parë që nga themelimi i saj ndërhyri drejtpërdrejt kur Serbia në krye me Millosheviqin po kryente spastrim etnik dhe gjenocid mbi popullin shqiptar në vendin tonë, brenda kontinentit evropian dhe para syve të gjithë botës”, ka thënë Konjufca, duke shtuar se këtë të shkuar ne e mbartim me dhimbje, por edhe me krenari të madhe, duke punuar në suaza të kësaj fryme, për një shtet që mbron vlerat e demokracisë, në emër të të cilave erdhi edhe ndërhyrja e NATO-s. “Në këtë kuptim, edhe dje, edhe

sot, ishim dhe jemi bashkë, Kosova dhe NATO me të njëjtat vlera të njerëzve dhe popujve të lirë. Sot Republika e Kosovës aspiron anëtarësim sa më të shpejtë në NATO. Këtë na e definon historia. Ajo që besojmë e për çka angazhohemi. Prandaj jemi të bindur dhe besimplotë se shtetin tonë do ta shohim në NATO në një të ardhme jo të largët, aty ku përkasim”, ka theksuar Konjufca.

Pas masakrës së Reçakut, në mars të vitit 1999, NATO-ja ka nisur sulmet në caqet ushtarake policore në ish-Jugosllavi. Pas 78-ditësh të sulmeve, bombardimet janë ndërprerë më 10 qershor 1999, me Marrëveshjen Teknike të Kumanovës, e cila parashihte tërheqjen e të gjitha forcave ushtarake dhe policore serbe nga Kosova.

Marrëveshja është pasuar nga miratimi i Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Kjo Rezolutë ka qenë kompromis i pesë vendeve të përhershme anëtare të Këshillit të Sigurimit në bazë të së cilës në Kosovë vendosej një administratë e Kombeve të Bashkuara - UNMIK, e cila administronte fazën transitore deri në ngritjen e institucioneve vendore dhe zgjidhjen e përhershme të statusit të Kosovës.

Më 12 qershor 1999 ka nisur vendosja e rreth 50 000 ushtarëve nga 36 vende të botës, prej të cilëve 30 000 ishin nga vendet e NATO-s. KFOR-i është i pranishëm edhe sot dhe kujdeset për sigurinë e Kosovës.

Në luftën e zhvilluar në Kosovë më 1998/99 janë vrarë mbi 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.





NË GLLOGJAN TË DEÇANIT MBAHET MANIFESTIMI QENDROR NË 26-VJETORIN E “EPOPESË SË DUKAGJINIT”

Në 26-vjetorin e ‘Epopesë së Dukagjinit’ bëhet thirrje që Kosova mos t’i ftohë raportet me aleatët strategjikë

Në shënimin e 26-vjetorit të “Epopesë së Dukagjinit” u bë thirrje që Kosova mos t’i ftohë raportet me aleatët strategjikë si dhe që shqiptarët të jenë bashkë për ta çuar deri në fund amanetin e atyre që ranë për lirinë që gëzojmë sot. Në “Epopenë e Dukagjinit” morën pjesë përfaqësues të partive politike opozitare, të niveleve lokale, veteranë të UÇK-së, përfaqësues nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Lugina e Preshevës, por jo edhe presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti, të cilët përmes “Facebook”-ut e kanë kujtuar këtë epope. Për dallim nga ta, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, me bashkëpunëtorë ka bërë homazhe në Glllogjan

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

GLLOGJAN, 24 MARS - Në Glllogjan të Deçanit të dielën është shënuar 26-vjetori i “Epopesë së Dukagjinit”. Aty morën pjesë përfaqësues të opozitës, të niveleve lokale, veteranë të UÇK-së, përfaqësues nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Lugina e Preshevës, por jo edhe presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti, të cilët përmes “Facebook”-ut e kanë

kujtuar këtë epope. Për dallim nga ta, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, me bashkëpunëtorë, ka bërë homazhe në Glllogjan. I pranishëm në “Epopenë e Dukagjinit” ishte edhe kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Talat Xheferi, lideri i BDI-së, Ali Ahmeti dhe ministra të këtij vendi. Rifat Jashari, i cili ishte i pranishëm në shënimin e 26-vjetorit të “Epopesë së Dukagjinit”, tha se kur të bëhen

bashkë shqiptarët, arrihet amaneti i atyre që kanë rënë brez pas brezi. “Dashtë Zoti gjithmonë jemi bashkë, me Shqipëri, me Luginë të Preshevës, me Maqedoninë, me shqiptarët e Malit të Zi që të rrugëtojmë bashkë e t’i arrijmë qëllimet tona shekullore. Atëherë nëse bashkohemi e kemi arritur amanetin e atyre që kanë rënë brez pas brezi”, ka thënë ai. Kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se me 24



mars, në këtë datë historike, populli ynë mori kthesën e duhur dhe rrugën drejt lirisë, për të cilën punuan dhe u sakrifkuan shumë breza. “Po me këtë datë na kujtohen vuajtjet e këtij populli, krenaria, qëndresa, vetëmohimi, po ashtu mbrojtja e identitetit tonë, i nëpërkëmbur nëpër shekuj. Që një datë të jetë

historike e të nderohet përjetësisht, patjetër se duhet të ketë heronjtë e luftëtarët e saj. Heronjtë dhe dëshmorët e kësaj dite të dhimbshme dhe madhështore. E them e dhimbshme sepse atë ditë ranë tre bashkëluftëtarë të Luanit të UÇK-së, Gazmend Mehmetaj, Himë Haradinaj e Agron



Mehmetaj, të cilët janë pjesë e krenarisë sonë kombëtare. Heronjtë e gjallë të asaj dite, nën emblemën e UÇK-së, familja e shenjtë e Haradinajve bëri atë që përgjatë historisë sonë si komb ishte e paparë dhe e pa dëgjuar ndonjëherë. Shumë e vështirë ta thuash me fjalë historinë prej luftëtari që bëri atë ditë komandanti i Zonës Operative të Dukagjinit, gjeneral Ramush Haradinaj. Në këtë ditë lindi dhe u brumos shpresa jonë si komb, që liria për ne tashmë kishte ardhur pavarësisht prej çmimit të madh që paguam si komb”, ka thënë Ramosaj.

Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, në fjalimin e tij në shënimin e 26-vjetorit të “Epopesë së Dukagjinit”, ka thënë se kjo epope ishte përgjigjja heroike e atdhedashësve në fillimin e luftës në Dukagjin. “Të ndërtosh një shtet nuk është lehtë. Akoma më vështirë është kur, për ta ndërtuar shtetin, duhet të luftosh dhe të sakrifikosh më të çmuarën, sidomos tani kur konsiderohet se civilizimi njerëzor duhet t’i ketë tejkaluar apetitet megalomane. Dje i ka pranuar të drejtat dhe vlerat universale mbi të cilat zhvillohen shoqëritë demokratike bashkëkohore. Por ja që leksionet e hidhura tentojnë të përsëriten për çdo dekadë dhe në raste të tilla ndihma, përkrahja dhe mbështetja e aleatëve dhe partnerëve strategjikë është thelbësore dhe e pazëvendësueshme”, ka thënë Xhaferi, i cili më tej ka folur për

mbështetjen e ndërkombëtarëve, të NATO-s dhe ShBA-së, duke kujtuar lansimin e parë të raketës që, sikundër tha ai, duhet të mbahet në mend dhe të nderohet. Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, para pjesëmarrësve ka thënë se epopeja e marsit është një nga ditët më të shënuara në histori. Ai ka thënë se shqiptarët duhet të jenë përjetë mirënjohës ndaj Amerikës dhe NATO-s. “Epopeja e marsit do të mbetet nga ditët



më të shënuara në histori, sepse të gjithë këta të rënë deshën të jenë në krah të komandantit legjendar Adem Jashari për ta lehtësuar dhimbjen dhe për të dhënë lajmin se Kosova u çlirua nga gjaku dhe ndihma nga aleati. Prandaj mirënjohës për jetë të jetëve, shqiptarët duhet të jenë ndaj Amerikës, NATO-s, sepse ne si komb ndodhemi në një rajon i cili duhet të ketë miqësi të fortë dhe kjo miqësi është bërë në momentin më të duhur që shqiptarëve u është

dashtë”, ka thënë Ahmeti. Ai ka shtuar se Kosova duhet të jetë e kujdesshme dhe të mos lejojë ftohje as neglizhencë ndaj aleatëve strategjikë e historikë të kombit. “Sepse Kosova ende ka nevojë ta marrë përfundimisht fizionominë e një shteti të pranuar ndërkombëtarisht. Dhe ky duhet të jetë misioni ynë dhe pikërisht këtu”, ka deklaruar lideri i BDI-së. Ish-komandanti i UÇK-së për



përgjigje me luftë, me zjarr, me sulme, pas asaj që ndodhi në Prekaz. Kuptohet, edhe frikën e kishim, për shkak se ishte në pyetje rrjedha e luftës, jo veç çka do të ndodhte, nëse do të sulmoheshim ne, a do të



vriteshim të gjithë ne, por çfarë do të ndodhte me luftën. Pra, keni parasysh, dy herë frikë. Një herë për jetën e secilit, e dyta për fatin e luftës sonë. Ka dashtë Zoti atë ditë që po, janë vlarë do djem të mirë që i kujtojmë sot, djem të zotë, por nuk u vra lufta atë ditë.

Pra kjo është me rëndësi në fund të ditës. Këtu, në këtë vend, në këtë truall, kanë mbetur shqiptarët, e kanë ikur forcat e Millosheviqit. Kjo është e vërteta e kësaj dite”, ka thënë Haradinaj, duke theksuar se shqiptarët nuk e kanë lëshuar këtë tokë asnjëherë. “Nuk e kemi lëshuar këtë tokë asnjë ditë të luftës. Forcat e Millosheviqit i kanë rënë në shumë drejtime, po kurrë një herë kjo tokë s’ka qenë pa ne, pa UÇK-në. Pra, asnjë ditë të lume të luftës. Më 24 mars ’99 Millosheviqi e mori atë që i takonte, atë që u kishte bërë shumë familjeve shqiptare: atë që e bëri në Qirez, Likoshan, atë që e bëri në Prekaz, në Glogjan, në Meje”, ka thënë Haradinaj. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i shoqëruar nga deputetë të Kuvendit dhe anëtarë të kabinetit qeveritar, në shënim të 26-vjetorit të “Epopesë së Dukagjinit”, bëri homazhe në Kompleksin e Varrezave “Dëshmorët e Kombit” në fshatin Glogjan. Pasi vendosi lule në varrezat e të rënëve dhe nderoi sakrificën e tyre, kryetari Konjufca vizitoi edhe muzeun e kullës në kuadër të Kompleksit Memorial. Presidentja Osmani ka shkruar në “Facebook” se “Epopeja e Dukagjinit” është një nga kapitujt më heroik të luftës për liri të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Edhe kryeministri Kurti ka shkruar në “Facebook”, duke theksuar se bashkë me guximin e familjes Haradinaj, “Epopeja e Dukagjinit” dëshmoi vendosmërinë e popullit tonë për

çlirim. “Epopeja e Dukagjinit” shënon betejën frontale të 24 marsit 1998 midis UÇK-së dhe forcave serbe, pasi këto të fundit kishin sulmuar Glogjanin, njërin nga bazat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.



Kurti: Me qeverinë tonë fermeri i Kosovës është më i përkrahuri në rajon

PRISHTINË, 24 MARS - Kryeministri Albin Kurti ka thënë të dielën se fermeri i Kosovës është më i përkrahuri në rajon me qeverisjen e tij. “Rekord i tokës së punuar. Rekord i përkrahjes financiare për fermerë. Me qeverinë tonë, fermeri i Kosovës është më i përkrahuri në rajon. Patëm premtuar që do ta reformojmë e përmirësojmë sektorin e bujqësisë,

nëpërmjet eliminimit të keqmenaxhimit dhe keqpërdorimit të atëhershëm. Për këto tri vjet në total kemi ndarë mbi 226 milionë euro mbështetje financiare për fermerë përmes subvencioneve dhe granteve. Buxheti për bujqësi në vitin 2023 arriti vlerën më të lartë ndonjëherë, mbi 100 milionë euro, duke tejkaluar kështu edhe premtimin tonë. Për

herë të parë subvencionohen nafta dhe plehu bujqësor. Sigurimeve bujqësore u janë shtuar edhe gjashtë kultura të reja. Eksporti i produkteve bujqësore ka shënuar rritje të vazhdueshme. Në vitin 2023 ishte për 29% më i lartë se në vitin paraprak”, ka shkruar Kurti në “Facebook”. Ai ka thënë se për sivjet kanë siguruar 26.4 milionë euro për ujitje dhe agroturizëm nga

marrëveshjet ndërkombëtare, ndërkohë për tri vjet kanë pyllëzuar mbi 563 ha sipërfaqe të zhveshura të pyjeve dhe mbjellë mbi 1.4 milionë fidan. “E për të siguruar meritokracinë që ka munguar në të kaluarën, përveç mirëbesimit në rritje, janë realizuar shumë kontrolle të rregullta. Vetëm në vitin 2023 janë bërë mbi 10 mijë sosh, ku në 7 komuna kontrolle është



realizuar deri në 100 %. Jemi të lumtur e krenarë që kemi mbështetur mbi 30 mijë fermerë meritokracinë”, ka theksuar Kurti.

Autoritetet në Kosovë: Është avancuar statusi i vendit në Asamblenë Parlamentare të NATO-s

PRISHTINË, 24 MARS - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka bërë me dije të dielën, se në 25-vjetorin e fillimit të sulmeve të NATO-s vendi ynë po shënon një kapitull të ri me lajmin se Komisioni i Përhershëm drejtues i Asamblesë Parlamentare të NATO-s ka marrë vendimin që Kosova nga vëzhgues parlamentar, të pranohet shtet anëtar i asociuar. “24 marsi i vitit 1999 shënoi një momentum të ri për Kosovën dhe përpjekjen e saj për liri dhe shtet të pavarur, gjersa sot me këtë vendim të NATO-s jemi edhe një hap më afër drejt përmirësimit të qëllimit tonë si shtet i pacenueshëm e për Ballkan stabil”, ka shkruar Maqedonci në “Facebook”.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Driton Hyseni, njëherësh kryesues i delegacionit të Kuvendit të Kosovës në këtë Asamble, ka thënë se ky “është niveli më i lartë i prezencës në Asamble deri në anëtarësim të



plotë të Kosovës në NATO”, dhe se vendimi do të zyrtarizohet përmes një votimi në Asamblenë Parlamentare të NATO-s në sesionin pranveror, më 27 maj,

në Sofje. “Me ngritjen e nivelit të përfaqësimit të Kosovës në Asamblenë e NATO-s, ne do të kemi zgjerim të delegacionit, përfshirje më të madhe në

vendimet e Asamblesë dhe do të kemi të drejtë në adresimin e amendamenteve dhe komenteve për secilin proces e dokument i cili trajtohet nga

Asambleja, të cilat më herët është dashur të bëhen përmes delegacioneve të vendeve tjera, kryesisht Shqipërisë”, ka thënë Hyseni përmes një postimi në “Facebook”.

Këtë lajm e ka bërë me dije edhe deputeti i PDK-së, njëherësh nënkryetar i Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë dhe anëtar Delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, Xhavit Haliti. “Kosova pritet të pranohet partner i acociuar në Asamblenë Parlamentare të NATO-s si rezultat i angazhimit shumëvjeçar të delegacionit të Kuvendit të Kosovës. Votimi formal do të bëhet në mbledhjen e sesionit të ardhshëm të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, i cili do të mbahet në Sofje të Bullgarisë. Aktualisht, Kosova ka statusin e vendit vëzhgues në Asamblenë Parlamentare të NATO-s”, ka shkruar Haliti në “Facebook”.

Agani: Shqetësues largimi i profesionistëve shëndetësorë



PRISHTINË, 24 MARS - Ish-ministri i Shëndetësisë, Ferid Agani, në një intervistë për “Ekonomia Online”, ka thënë se largimi i profesionistëve shëndetësorë nga vendi është një dukuri brengosëse dhe paralajmëron se brenda disa vitesh vendi mund të përballet me mungesë serioze të ofrimit të shërbimeve shëndetësore. Agani ka thënë se reforma në sistemin shëndetësor, e cila kishte filluar në vitin 2015 me mbështetje të Bankës Botërore e të FMN-së, ishte ndalur dhe aktualisht tërë sistemi

shëndetësor është i ngulfatur dhe gjendet në një gjendje të ngutisë dhe të konfuzionit. “Dukuri tejet brengosëse dhe shumë fatkeqe, posaçërisht për mua si ish-ministër i Shëndetësisë, që në vitin 2010 e pati dizajnuar reformën e sistemit shëndetësor të vendit dhe mandej gjatë mandatit 2011-2014 e patëm shndërruar atë reformë në një kornizë legjislative të qëndrueshme të mbështetur nga Banka Botërore, nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Në vitin 2015 filluam ta zbatojmë atë reformë me ndarjen e

kontributeve për të punësuarit në sistemin publik, kontributeve për fondin e sigurimeve shëndetësore dhe në kulmin e shpresave se kjo reformë do të vazhdojë, erdhi deri te ndërprerja e vazhdeve e asaj ndërhyrje politike të qartë dhe praktikisht reforma ngeci aty ku u nis në vitin 2015. Për mua kjo është një fatkeqësi e madhe që e ka goditur shoqërinë e Kosovës. Unë kam qenë thellë i bindur që 10 vjet pas fillimit të reformës ne do të krenohemi në Kosovë me një sistem shëndetësor më bashkëkohor”, ka thënë Agani.

Kosova në Panairin e Librit në Leipzig '24

PRISHTINË, 24 MARS - Në Leipzig është hapur Panairi i Librit. Edhe këtë vit Kosova është përfaqësuar nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës, e cila ka paraqitur disa botime të botuesve të Kosovës. Shtandi i Kosovës në panair

është vizituar nga përfaqësues të Panairit të Librit në Leipzig, po ashtu nga ambasadori i Kosovës në Berlin, Faruk Ajeti, ambasadorja e Shqipërisë në Berlin, Adia Sakiq dhe ambasadori i Maqedonisë së

Veriut në Berlin, Ylber Sela. Pjesëmarrja e Kosovës në Panairin e Librit në Leipzig është përkrahur nga Ministria e Kulturës dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Panairi ka qenë i hapur deri dhe, 24 mars 2024.



Murati kundërshton akuzat e Abdixhikut dhe Hotit për humbje në Trust

PRISHTINË, 24 MARS - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka kujtuar disa deklarata të kryetarit të LDK-së, Lumir Abdixhiku dhe deputetit të kësaj partie, Avdullah Hoti, lidhur me kursimet e Trustit. Murati në “Facebook” ka shkruar se para një viti Abdixhiku dhe Hoti kishin nisur një fushatë dezinformimi në lidhje me kursimet e Trustit dhe performancën e investimeve.

“Sipas logjikës së Abdixhikut e Hotit, Trusti do të duhej t’i kishte humbur një 180 milionë euro deri më sot për një vit. Por ja që koha, bashkë me performancën e investimeve në Trust, tregon edhe njëherë se njohuritë e ekonomistëve të LDK-së janë të mjaftueshme vetëm sa për të llogaritur se sa duhet kthyer kusuri, por jo për gjëra më të thella”, ka shkruar Murati. Kryetari i Lidhjes Demokratike

të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, kishte akuzuar qeverinë se nuk po bën asgjë për, siç ka thënë, humbjen e vlerës së kursimeve pensionale në Fondin e Kursimeve Pensionale. Ai në rrjetin social në “Facebook” një vit më parë kishte shkruar se përdërisa kursimet pensionale humbasin vlerë nga gjysmë milion euro në ditë, popullistët vazhdojnë rehatinë.



Rreth 70 për qind e blerësve në patundshmëri vijnë nga diaspora



PRISHTINË, 24 MARS - Mërgata vazhdon t’i shpenzojë paratë në Kosovë për blerjen e patundshmërive, kryesisht të banesave, kështu thotë për “Ekonomia Online” pronari i kompanisë “Pozhegu Brothers”, Qemajl Pozhegu. Por blerja e patundshmërive nuk duhet të llogaritet si investim i huaj nga profesori i ekonomisë, Safet Gërxhaliu. Pozhegu ka thënë se në kompaninë e tij rreth 70 për qind e blerësve janë nga diaspora. E kjo, sipas Pozhegut, ka ndodhur për shkak të rritjes së çmimeve në Evropë. “Shumica e blerësve për

momentin në kompaninë tonë janë nga diaspora, mbi 60-70 për qind, për shkak se atje është rritur norma e interesit, janë rritur çmimet e pronave dhe për ata është më e lirë të blejnë në Kosovë. Çmimet fillojnë prej 999 eurosh për metër katror deri në 1 400 euro, varësisht prej lokacionit e në cilën fazë të ndërtimit dhe si është mënyra e pagesës”, ka thënë Pozhegu. Sipas Pozhegut, trajektorja e ndërtimeve në Kosovë është duke vazhduar, por jo me përmasa të mëdha. “Trendi i ndërtimeve është me një trajektore të vazhdueshme”, u shpreh Pozhegu.

Por njohësi i çështjeve ekonomike, Safet Gërxhaliu, ka thënë se shumica e remitencave është më e madhe sesa dihet. Ai kërkon që blerja e patundshmërive nga diaspora të mos llogaritet si investim i huaj. “Padrejtësia më e madhe që i bëhet diasporës është fakti që thuhet se diaspora dërgon në Kosovë vetëm 1 miliard e 100 milionë euro. Ne këtu flasim për dërgesat të cilat vijnë përmes transaksioneve bankare financiare, ndërsa realiteti është krejt tjetër. Shumë më tepër kontribuon diaspora se këto që janë të evidentuara. Në rend të

dytë, themi me përgjithësi se kontributi i diasporës është i barabartë me buxhetin i cili miratohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sepse dërgesat më të mëdha apo investimet më të mëdha të diasporës bëhen atëherë kur ata qëndrojnë në Kosovë, dhe e treta definitivisht duhet të ndërpritet ky avaz që blerja e patundshmërisë dhe pronat nga diaspora të llogariten si investime të huaja. Kosova ka nevojë për investime direkte që gjenerojnë vende të reja të punës, rritin eksportin dhe përmirësojnë imazhin”, ka deklaruar Gërxhaliu,

i cili Kosovën e sheh më pak të favorshme nga investorët. “Sot, për fat të keq, në Kosovë nuk dëshiron askush të investojë. Dhe çka është më shqetësuese, numërohen njerëzit të cilët e braktisin Kosovën, por kurrë nuk e analizon dikush faktin se po ikën kapitali i komunitetit të biznesit dhe i qytetarëve. Ne kemi rënie apo tkurje të eksportit në vitin 2023, kemi rënie të investimeve kapitale, dhe kështu kemi rritje të varfërisë. Nëse këto janë indikatorë pozitivë atëherë është një fenomen që shkenca duhet ta hulumtojë”, ka thënë Gërxhaliu.

Senati shmang sërish mbylljen e qeverisë amerikane, miraton një paketë për shpenzime në vlerë 1.2 trilion dollarë

UASHINGTON, 24 MARS - Senati amerikan e ka miratuar një paketë për shpenzime në vlerë të 1.2 trilion dollarëve amerikanë për ta shmangur kërcënimin e mbylljes së qeverisë amerikane. Dokumenti i miratuar në orët e para të së shtunës tani do të shkojë në tavolinën e presidentit amerikan Joe Biden për nënshkrim. Kongresi e ka miratuar javë më parë një paketë që garanton fonde për veteranët, agjencitë për punë të jashtme, të

brendshme dhe ato të bujqësisë, ndërsa pajtueshmëria e arritur të shtunën garanton fonde për departamentet e mbrojtjes, sigurisë kombëtare dhe agjenci të tjera qeveritare. Ligjvënësve amerikanë u janë dashur gjashtë muaj pas hyrjes në vitin e ri fiskal për të përmbyllur pothuajse gjithë buxhetin për shpenzime. Kombinimi i dy pakove financiare për shpenzime lë të kuptohet se buxheti amerikan për këtë vit do të jetë rreth 1.66

trilion dollarë. Aty nuk përfshihen fonde për zvogëlimin e borxhit shtetëror. Në asnjërin prej pakove nuk është përfshirë ndihma ushtarake në vlerë të 60 miliardë dollarëve për Ukrainën, e cila ka nisur ta vërejë mungesën e municioneve, teksa lufton pushtimin rus, të nisur në shkurt të vitit 2022. Republikanët konservatorë janë duke e bllokuar ndihmën, me arsyetimin se duhen zbatuar politika më të ashpra për migrantët në kufijtë amerikanë.



DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (10)



Prof. dr. Sabit SYLA & Prof. dr. Hamit KABA

-22-

PS/Z. Blaker
5 maj 1981
Vizitë e ambasadorit jugosllav: 6 maj ora 11.00 am

1. Ambasadori jugosllav do të bëjë një vizitë nesër, me kërkesën e tij, tek z. Blaker. Ai ka nënkuptuar se dëshiron të diskutojë çështje të OSBE-së, politikën e BE-së në Azinë Jugore dhe Gjirin e Meksikës, dhe “marrëdhëniet e Jugosllavisë me një prej fqinjëve të saj” (që mendojmë se është Bullgaria ose ka të ngjarë Shqipëria). Bashkangjitur po ju dërgoj një notë me pikat që do të diskutoni dhe disa fakte thelbësore.
2. Z. Gray do të marrë pjesë në vizitë për të mbajtur shënime.

A. E. Montgomery
Departamenti Sovjetik & Evropës Lindore

-23-

Vizitë e ambasadorit jugosllav tek z. Blaker: 6 maj
Çështjet për diskutim
OSBE

... Shqipëria: Trazirat në Kosovë

18. Ngjarjet janë ndjekur me shumë interes. Jemi të kënaqur që trazirat kanë rënë. Nuk ka rënie në mbështetjen e Qeverisë së Madhërisë së Saj për stabilitetin dhe integritetin territorial të Jugosllavisë. Shenjë e këtij qëndrimi është miratimi kohët e fundit nga ana jonë për të eksportuar në Jugosllavi një sasi të konsiderueshme pajisjesh të sigurta për kontrollin e trazirave.

-24-

Procesverbal i bisedës ndërmjet ambasadorit jugosllav dhe ministrit të shtetit, Zyra e Jashtme dhe Komonuelthit: 11 am më 6 maj 1981
Të pranishëm:
Z. P A R Blaker
Z. Berisavljeviç, ambasadori jugosllav
Z. J. Macgregor
Z. J C R Gray

1. Pas përshëndetjeve të përzemërta, ambasadori tha se ishte i kënaqur me situatën e marrëdhënieve midis Britanisë dhe Jugosllavisë. Pas vizitës së kryeministres në shtator 1980 marrëdhëniet ruajtën po atë ritëm.
2. Ambasadori dëshironte të diskutonte marrëdhëniet e Jugosllavisë me fqinjët e saj, dhe në veçanti me Shqipërinë: kjo marrëdhënie ishte ndërlikuar që prej trazirave të fundit në Kosovë. Autoritetet po i analizonin ende këto ngjarje, të cilat kishin ndodhur aq papritur. Duket se për këtë ka tre

shpjegime themelore. Së pari, përkeqësimi ekonomik i Jugosllavisë kishte ndikuar disproporcionalisht në Kosovë, dhe kjo situatë nga ana e saj e ka rënduar pakënaqësinë që ndjehet në Kosovë për varfërinë e saj relative krahasuar me Slloveninë dhe Kroacinë të cilat gjatë viteve të fundit ishin zhvilluar shumë shpejt. Së fundmi, kishte faktorë të rëndësishëm politikë. Autoritetet e kishin nënvlerësuar forcën e ndjenjës kombëtare shqiptare. Por, pika më shqetësuese ishte se autoritetet shqiptare dukej qartazi që ishin përfshirë thellësisht në këto trazira në një kohë kur marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave ishin më të mirat që në vitin 1949. Tregtia ishte rritur me shpejtësi. Për pasojë, autoritetet jugosllave ishin veçanërisht të shqetësua për këtë aspekt. Ato nuk kishin informacion të saktë se çfarë po ndodhte në Shqipëri por dukej që aty zhvillohej luftë për pushtet. Z. Blaker pyeti nëse ambasadori nënkuptonte se ngjarjet në Kosovë kishin lidhje me ndryshimet e mundshme në udhëheqjen shqiptare. Ambasadori theksoi se Shqipëria po përpiqej të kapërcente izolimin e vetimponuar. Kjo politikë duket se ka shkaktuar përçarje në radhët e udhëheqjes.

3. Por, ky nuk ishte presioni i vetëm për Jugosllavinë. Edhe linja bullgare ishte shqetësuese. Polemikët e kohëve të fundit në veprat historike bullgare ishin frymëzuar qartazi nga burime zyrtare dhe sugjeronin, për shembull, se Jugosllavia ishte çliruar nga trupat bullgare në fund të Luftës së Dytë Botërore dhe se maqedonasit ishin një komb “i shpikur”. Pikërisht kjo ishte arsyeja pse jugosllavët ishin të shqetësuar për festimet e ardhshme të përvjetorit të 1300-të të shtetformimit të Bullgarisë. Siç sugjeronin disa analistë në Londër, ata e kishin të vështirë të besonin se festimet do të ishin një manifestim i nacionalizmit bullgar përballë Bashkimit Sovjetik. Një gjë e tillë ishte e paimagjinueshme. Nacionalizmi bullgar drejtohej gjithmonë kundër Jugosllavisë. Kështu, z. Blaker do ta kuptonte që jugosllavët ishin të shqetësuar se si mund të lindnin praktikisht njëherësh dy burime të veçanta presioni.

4. Z. Blaker tha se shpresonte që ambasadori e kishte kuptuar qartë se mbështetja e Qeverisë britanike për unitetin e Jugosllavisë nuk kishte ndryshuar. Ambasadori e miratoi pohimin e tij. Z. Blaker tha se në mungesë të marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, ekzistonin limite të qarta të influencës që qeveria britanike mund të sillte për qeverinë shqiptare. Por ne asnjëherë nuk do të mbështesnim asnjë kërcënim ndaj integritetit të Jugosllavisë. Gjithashtu, as nuk do të mbështesnim aspiratat bullgare ndaj territorit jugosllav. Për sa i përket përvjetorit të 1300-të, ambasadori u vu në dijeni se Komitetit Britanik i Nderit përbëhej nga figura akademike dhe kulturore të kryesuara nga Lordi Goronwy-

Roberts. Nuk kishim arsye të besonim se bullgarët do të shfrytëzonin përvjetorin për propagandë antijugosllave në Mbretërinë e Bashkuar. Qeveria britanike nuk do të hiqte dorë nga neutraliteti i saj i rreptë në çështjen e Maqedonisë dhe nuk do të bëhej palë në asnjë përpjekje për të shfrytëzuar festimet për propagandë në këtë çështje.
OSBE

5. Z. Blaker tha se hartimi i një dokumenti neutral dhe mosangazhimi do të shërbente si bazë e dobishme për diskutime të mëtejshme. BRSS-ja vazhdonte ende me idenë e një konference për detantën ushtarake dhe çarmatimin. Por, nuk ka pasur progres në çështje që lidhen me të drejtat e njeriut, marrëdhëniet dhe çështje të informimit. Po bëhej e vështirë për ne t'i bënim rusët të përcaktonin se çfarë nënkuptonin me propozimin e tyre që CBM-të duhet të zbatohen për të gjithë pjesën evropiane të Bashkimit Sovjetik me kusht që në këtë mënyrë Perëndimi të zgjeronte zonën e besimit. Po kështu, nuk ishim të përgatitur që të ndaleshim përgjithmonë në çështjen e Madridit. Zvarritja e tepërt mund të zhvlerësonte OSBE-në siç kishte ndodhur me MBFR. Ambasadori pyeti nëse do të vendosnin diçka të ngjashme me formulën që ishte arritur në Beograd në rast se nuk përfitohej një dokument thelbësor final. Z. Blaker tha se ne shpresonim për një marrëveshje më të ekuilibruar, por që në rast se nuk do ta arrinin këtë, atëherë do të prananim minimalisht diçka të ngjashme me formulën e Beogradit me kusht që të nesërmen të përfshinte marrëveshjen.
6. Takimi përfundoi në orën 11.00.

Shpërndahet për:
PS/Z. Blaker
Z. Bullard
Z. Fergusson
EESD
Departamenti i OSBE
Departamenti i Kërkimit
Kancelaritë: Beograd, Sofje

-25-

Për përdorim të kufizuar

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
Beograd
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit, 5 maj 1981
Inderuar Charles,

Kosova: Situata e sigurisë

1. Në telegramin tonë nr. 56, të datës 30 prill, tregojë vështirësia e vazhdueshme e autoriteteve për të dalë në krye të situatës së sigurisë në Kosovë. Gazeta “Politika”, në një dalje paraprake të artikullit të datës 4 maj për mbledhjen e sotme të Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës për të cilën do të raportojmë më vete, ka shpjeguar në detaje seriozitetin e problemit.
2. Gazeta “Politika” tha se sot, 35 ditë

pas demonstratave, situata ishte “më e qetë” por mbetej “shumë e vështirë”. Gjatë ditëve të fundit, veçanërisht më 1 maj, armiku ka vazhduar të rrisë tensionin përmes akteve të vogla të provokimit. Gjatë 10 ditëve të fundit grupe të rinjsh janë shfaqur në të njëjtën kohë në disa qytete, duke vepruar në mënyrë provokative dhe nacionaliste, me veshje kombëtare shqiptare, simbole të veçanta apo bluza me shqiponjën dykrerëshe shqiptare. Udhëheqësi i një grupi prej 50 të rinjsh në Prizren ishte identifikuar si i biri i një emigranti shqiptar. Në fund të prillit dhe në fillim të majit ka patur incidente në Ferizaj, Suharekë, Lipjan, Rahovec, Istog dhe Pejë, të cilat nuk ishin lejuar të përshkallëzoheshin vetëm nga ndërhyrja energjike e forcave të sigurisë. Për të krijuar konfuzion për identifikimin e tyre, pjesëmarrësit në këto “demonstrata paqësore” vepronin qëllimisht jashtë qyteteve të tyre të lindjes. Megjithë përpjekjet për të shkaktuar trazira, armiku nuk kishte arritur të ndërpriste punën apo festimin e 1 majit. Gazeta “Politika” konkludoi se detyra e autoriteteve nuk ishte kurrësi e lehtë dhe nuk ishte diçka që mund të zgjidhej brenda pak ditësh. “Rrënjët janë më të thella dhe së pari nevojitet që këto rrënjë të priteshin”.
3. Kështu, ky raport konfirmon se të rinjtë po vazhdojnë të veprojnë në mënyrë të organizuar pak a shumë në të njëjtën zonë ku janë zhvilluar demonstratat e mëparshme. Raporti tregon se ata janë të përgatitur të rrezikojnë përballë prezencës së konsiderueshme të forcave të sigurisë dhe se liderët kryesorë nuk janë duke u kapur.

I Juaji,
T. J. Clark
Për dijeni: P. Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit, FCO

-26-

Konfidenciale

GR 500
Fm Beograd 061009Z, maj
Prioritet për FCO
Kopje origjinale
Nr. tel. 058, datë 6 maj 81
Informacion për UKDEL NATO
Kopje për Washington (FCO PSE PASS)
Telegrami im nr. 56

Kosova

1. Komiteti Krahinor i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës u mblodh gjatë gjithë ditës, më 5 maj, për të diskutuar shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve të fundit.
2. Mbledhja u raportua plotësisht në shtyp dhe të gjithë folësit dënuan haptazi udhëheqjen e Partisë së Kosovës pse nuk kishte vlerësuar situatën në mënyrë korrekte dhe nuk kishte marrë masat e duhura. Dorëheqja e Kryetarit aktual të Partisë, Bakallit u pranua, siç duket, herën e tretë që u kërkua. Ai u zëvendësua nga Veli Deva, veteran i Partisë, për një periudhë 1-vjeçare.
3. Shkaqet kryesore të ngjarjeve iu atribuan së pari, irredentizmit

shqiptar, i mbështetur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Shqipëria, si dhe disa organizatave emigrantësh, gjoja të financuara nga organizata të shërbimit të fshehtë. U kritikua në mënyrë implicite politika federative në drejtim të marrëdhënieve “me çdo çmin” me Shqipërinë. U identifikuan edhe dobësi të tjera në sistemin e mbrojtjes së të gjithë njerëzve dhe vetë-mbrojtjes sociale, të cilët nuk ishin pajisur dhe nuk ishin në gjendje të mjaftueshme për të trajtuar situatën në momentin e duhur; u kritikua sistemi arsimor i cili varej shumë nga materialet mësimore dhe stafi shqiptar dhe nuk ishte përshtatur siç duhet me nevojat e krahinës; gjithashtu u kritikua prapambetja relative e krahinës, krahasuar me pjesën tjetër të Jugosllavisë. U diskutua marrja e masave të ndryshme për të rishikuar sistemin politik, arsimor dhe të sigurisë.

4. Mbledhja konfirmoi se ende nuk ishte zbuluar qendra që kishte organizuar aktivitetet armiqësore. Vazhdonte shkrimi i parullave, shpërndarja e broshurave dhe fletushkave, përhapja e dezinformimit dhe formave të tjera të provokimit. Ishin bërë përpjekje për të krijuar trazira gjatë festës së majit, por nuk pati incidente serioze.

5. Është e qartë që Partia tani do të bëjë spastrimin e radhëve të saj, ndoshta pas mbledhjes së sotme të Komitetit Qendror serb dhe pas mbledhjes së nesërme të Komitetit Qendror jugosllav. Do të ndiqet me forcë një program i veprimit politik për çrrënjosjen e elementëve armiqësor dhe mund të rishikohet në mënyrë drastike politika aktuale e miqësisë me Shqipërinë. Por, nuk doli një zgjidhje e qartë për problemin kryesor të statusit të Kosovës: udhëheqja vazhdon të qëndrojë e vendosur për pandashmërinë e Kosovës nga Serbia. Pra, ka të ngjarë që pakënaqësia nacionaliste do të vazhdojë.

Bolland
[Përsëritet sipas kërkesës]
Ky telegram nuk është përcjellë.

-27-

GR 1000
Fm Beograd 080909Z, maj
Prioritet për FCO
Kopje origjinale
Nr. tel. 060, datë 8 maj '81
Informacion për UKDEL NATO
Saving Washington (FCO PSE PASS)
Telegrami im, nr. 58

Kosova

1. Komiteti Qendror i Jugosllavisë u mblodh, më 7 maj. Mojsov, president i Kryesisë, mbajti fjalimin kryesor i cili sipas tendencës së re u transmetua mbrëmë në televizor dhe u publikua sot në shtyp.
2. Për herë të parë në një nga forumet që ka shqyrtuar ngjarjet në Kosovë, Mojsov e quajti si organizatore “Partinë Komuniste Marksiste-Leniniste të Shqiptarëve në Jugosllavi”. Ai e përshkroi atë si “Qendër e agjencisë së huaj” e

maskuar pas parullave nacionaliste-irredentise dhe marksiste-leniniste, udhëheqësit kryesorë të së cilës do të dilnin shpejt para gjyqit për t’u përgjigjur mbi aktivitetin kundërrevolucionar që ata e kishin organizuar me kujdes për një periudhë të gjatë.

3. Ai fajësoi Lidhjen e Komunistëve të Kosovës si shumë të ngadaltë dhe hezituese për të vlerësuar me korrektësi situatën dhe që nuk mori masat e nevojshme politike dhe të sigurisë. Për shumë vite, organizatat e Lidhjes së Komunistëve në Kosovë, kishin nënvlerësuar rrezikun e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar, gjë që kishte bërë që armiku të ishte në gjendje të depërtonte në organizatën e lidhjes së komunistëve dhe organizata të tjera socio-politike, veçanërisht në organizatën e të rinjve. Tashmë ishte e nevojshme “të gjendeshin dhe spastroheshin të gjithë ata që ishin molepsur me ndjenjën e nacionalizmit... veçanërisht në udhëheqjen dhe organizatat e Lidhjes së Komunistëve të Kosovës”. Ai pranoi se Partia jugosllave në tërësi ishte fajtorë gjithashtu sepse ishte treguar “e butë dhe e shkujdesur”.

4. Mojsov, bëri thirrje që të zhvilloheshin reforma në politikën aktuale për zhvillim ekonomik në drejtim të Kosovës dhe për përmirësime në perspektivat e punësimit për të rinjtë. Ai theksoi se duhet vënë kufiri midisi “Shpalljes kombëtare” të popullit shqiptar si dhe nacionalizmit dhe irredentizmit. Vetëm në një referencë të shkurtër për Shqipërinë ai u ankua se ishte lejuar pa pengesa indoktrinimi i të rinjve me ndjenjën e nacionalizmit përmes propagandës në tekstet shkollore dhe prej mësuesve nga Shqipëria. Sulmi kryesor ndaj Shqipërisë iu la Milosh Miniçit, i cili duke përdorur një gjuhë të fortë, kritikoi së pari “verbërinë e jashtëzakonshme dhe pakujdesinë, e madje edhe naivitetin, pikë së pari të forcave tona politike dhe organeve shtetërore në Kosovë dhe jo vetëm”; së dyti, ai kritikoi udhëheqjen shqiptare përndërhyrje “brutale” në punët e brendshme të Jugosllavisë dhe që kishte dëmtuar “me ashpërsi” marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve. Miniç, shtoi se Jugosllavia mbetej e gatshme për të ndërtuar marrëdhënie të fqinjësisë së mirë me Shqipërinë, përveç kur sjellja e kësaj të fundit e bën këtë të pamundur. Ndërkohë, ishte e nevojshme të bëheshin disa ndryshime në politikën e Jugosllavisë për t’i shpjeguar të rinjve në Kosovë veçanërisht pozitën e vërtetë të stalinizmit në Shqipëri, por pa nisur një fushatë kundër Shqipërisë, dhe për të rishikuar në mënyrë radikale bashkëpunimin kulturor dhe arsimor me Shqipërinë.

5. Mojsov, tha se si rezultat i shpjgimit të pamjaftueshëm në radhët e të rinjve, ishte krijuar iluzioni për pozitën kushtetuese të Kosovës se çështja e krijimit të Republikës ishte një çështje krejtësisht formale e cila mund të zgjidhej përmes presionit. Ai pohoi se duhet të respektohet pozita e Kosovës brenda Serbisë.

6. Mojsov, tha në mënyrë të përmbledhur: e gjithë çështja e zhvillimit të Kosovës është problem

i Jugosllavisë, problem për lidhjen e komunistëve si e tërë. Ai ishte i bindur se lufta kundër kundërrevolucionit do të sillte si pasojë që Jugosllavia të bëhej më e fortë dhe më e bashkuar. Pas diskutimeve, Komiteti Qendror mbështeti unanimisht deklaratën e Mojsovit.

7. Komiteti Qendror serb, i cili u mbledh më 6 maj, u përqendrua në mënyrë të mjaftueshme në aspektet serbe. Por, ky komitet njohu gjithashtu rreziqet më të gjera që vinin nga Kosova për marrëdhëniet ndërkrahinore në Jugosllavi në tërësi, veçanërisht si një stimul për nacionalizmin serb. Në këtë kontekst u vu në dukje me shqetësim migracioni i theksuar i serbëve dhe malazezëve nga Kosova.

8. Komiteti Qendror i Serbisë, njohu plotësisht dobësitë e organizatës së Lidhjes së Komunistëve në Kosovë si dhe faktorët ekonomikë dhe socialë si shkaqe të trazirave, por e quajti “verbëri politike” këndvështrimin jokritik që kishte marrë Jugosllavia në nxitjen e marrëdhënieve me Shqipërinë, zhvillimin e njëanshëm të tyre në favor të Shqipërisë si dhe mungesën e ekuilibrit midis Shqipërisë dhe Kosovës në vend të një ekuilibri të tillë në Jugosllavi në tërësi.

9. Komiteti Qendror i Serbisë bëri të qartë gjithashtu se nuk do të kishte ndryshime në statusin e Kosovës, por pranoi se një gjë e tillë nuk ishte shpjeguar në mënyrë të mjaftueshme më parë. Në bazë të Kushtetutës Federale dhe asaj serbe, krahinat autonome të Serbisë nuk mund të ishin të njëjta si Republikë, megjithëse në praktikë ato ishin të tilla në shumë drejtime. “Republikë është shteti që bazohet në sovranitetin e popullit të tij, në autoritetin dhe menaxhimin e klasës punëtore. Krahina autonome është komunitet socio-politik që bazohet në autoritetin dhe menaxhimin e klasës punëtore”. Problemi i krijuar këtu është se ishte besuar në mënyrë të gabuar që këto dy deklarata ishin të njëjta.

10. U miratua dorëheqja e Bakallit nga Komiteti Qendror i Serbisë dhe në vend të tij u pranua Deva si anëtar.

Bolland
(Përsëritet sipas kërkesës)
[Ky dokument nuk është përcjellë]

-28-
Konfidenciale

GR 1000
FM BEOGRAD 111315Z, maj
Direkt për FCO
Kopje originale
Nr. tel. 062, datë 11 maj 81
Informacion për UKDEL NATO
Kopje për Washington (FCO PSE PASS)
Saving Zagreb (Beograd PASS)
Telegrami im, nr. 58

Kosova

1. Konkluzionet e dala nga mbledhja e gjatë e Komitetit Qendror, më 7 maj, duhet të shqyrtohen në mbledhjen tjetër të Kryesisë së tij. Sidoqoftë, disa pika që kërkojnë vëmendje janë të qarta dhe sugjerojnë disa vendime të vështira, por potencialisht të dobishme në aspektin afatgjatë për unitetin e Jugosllavisë.

2. Pyetja kryesore që ka dalë nga të



gjitha këto debate të fundit është se si ishte e mundur për një organizatë me mbështetje të huaj, pra Partia Marksiste-Leniniste Shqiptare në Jugosllavi (PMLSHJ), të planifikonte dhe të kryente (duke supozuar se i ka kryer) një sërë demonstratash të mirëzbatuara ndërkohë që asnjë person me pushtet nuk e dinte se çfarë po ndodhte. Përgjigjja e pakëndshme mund të jetë se udhëheqja në Kosovë në fakt kishte dijeni, por për arsye që ende duhen sqaruar, nuk bëri asgjë për këtë. Për më tepër, ajo kishte dijeni për incidentet të tjera të shumta gjatë viteve të fundit dhe nuk kishte informuar autoritetet federale serbe. Shembulli që ka zemëruar pjesën më të madhe të popullit ishte heqja e portretit të Titos, me kërkesën e delegacioneve shqiptare vizitore, nga autobusët e mbushur me to dhe një muze që ata vizituan (drejtori i të cilit tashmë është pushuar). Sugjerimi kryesor është se shumë njerëz në vende të larta e simpatizonin shpalljen e aspiratave kombëtarë shqiptare.

3. Komiteti qendror serb dhe ai jugosllav, duhej të fajësoheshin gjithashtu për faktin se nuk ushtruan më shumë kontroll ndaj komunitetit “të mbyllur” të Kosovës, i cili e konsideroi çdo kritikë ndaj veprimeve të tij si një dëmtim i sovranitetit të tij të imagjinuar dhe ndërhyrje në punët e brendshme. Parimi bazë i centralizmit demokratik ishte thyer dhe vendimet e arritura në mënyrë kolektive në Komitetin Qendror jugosllav ishin shpërfillur pa pengesë në Kosovë.

4. Autoritetet qendrore duhet të mbajnë përgjegjësi kryesore gjithashtu për politikën e keqkuptuar haptazi ndaj Shqipërisë, dhe nëse Kosova ishte e lidhur kryesisht me zbatimin praktik të saj. Suksesi i shqiptarëve në infiltrimin dhe indoktrinimin e mësuesve, studentëve dhe fëmijëve të shkollave edhe duke mbyllur sytë, nënvizon naivitetin e mëtejshëm politik të Beogradit që shpresonte se Shqipëria nuk do ta shfrytëzonte situatën. Marrëdhëniet me Shqipërinë u diskutuan nga Kryesia Federale më 8 maj dhe, megjithëse nuk u dhanë detaje, mund të pritet që të ketë ndryshime të rëndësishme të politikës: për të siguruar një marrëdhënie më reciproke, për t’i dhënë fund pozitës pothuajse ekskluzive të Kosovës në

kontaktet me Shqipërinë, për të ndaluar depërtimin shqiptar përmes kulturës, dhe për të informuar publikun jugosllav për stalinizmin në Shqipëri.

5. Ka të ngjarë që të ketë ndryshime në sistemin e mbrojtjes së të gjithë njerëzve dhe vetëmbrojtjen sociale pasi, megjithëse është pranuar se mungesa e drejtimit politik është kryesisht gabim dhe forcat e armatosura zbatuan detyrën e tyre mbështetëse me kompetencë, milicia dhe njësitë territoriale shfaqën dobësi në trajtimin e situatës së brendshme të sigurisë për të cilën atyre u mungonin trajnimi dhe pajisjet e duhura. Një gjeneral i lartë e ka pranuar para këshilltarit tim se njësitë territoriale ishin trajnuar për të përballuar kërcënimin e jashtëm, por që tashmë ishte ndërmarrë një vështrim i ri në organizimin dhe trajnimin e tyre, jo vetëm në Kosovë, për pajisjen e tyre që të përballojnë kërcënimin e brendshëm, megjithëse sipas këndvështrimit të atashaut tim të mbrojtjes, kjo detyrë është kryesisht e milicisë. Vlen të thuhet se është bërë një porosi me nxitim për pajisje britanike kundër trazirave.

6. Politikanët dhe shtypi po përshëndesin sot ngjarjet në Kosovë për krijimin e mundësisë për t’u përballur me shumë probleme që kanë rezultuar nga politika e decentralizimit. Theksi po vihet në Kosovë si një problem për të gjithë Jugosllavinë që kërkon zgjidhje jugosllave kolektive. Shoh se nuk ka ndonjë perspektivë për t’u kthyer në një shoqëri të kontrolluar në mënyrë më të centralizuar, por më shumë në një përpjekje të rinovuar për inkurajimin e bashkëpunimit ndërmjet republikave e madje integrimin për të penguar nacionalizmin, veçanërisht reagimin e ashpër të serbëve në lidhje me rrezikimin e Federatës. Në të vërtetë, Serbia është e vendosur që të ripohojë sovranitetin e saj kushtetues ndaj dy krahinave autonome. Disa udhëheqës të Partisë kanë arritur në përfundimin se Jugosllavia mund të dalë nga kjo traumë më e bashkuar se kurrë.

7. Ndërkohë, situata e sigurisë mbetet e pazgjidhur. Problemi kryesor është në Universitetin e Prishtinës dhe disa shkolla, ku përveç kërcënimit për t’i dëbuar për mungesa, studentët vazhdojnë të bojkotojnë mësimin dhe të

kërkojnë lirinë e mësuesve të tyre nga burgu. Raportet e shtypit përmendin gjithashtu shpërndarjen e fletushkave dhe broshurave si dhe përhapjen e dezinformimit dhe frikësimit. Janë marrë kundërmasa për të pushuar nga puna dhjetëra mësues; deri tani mbi njëqind komunistë janë përjashtuar nga partia, janë spastruar institucionet kulturore dhe janë pezulluar disa gazetarë dhe redaktorë.

8. Kështu, duket se prioritet janë si më poshtë:

a) të çrrënjoset opozita nacionaliste shqiptare në Kosovë përmes një operacioni të përbashkët të sigurisë dhe spastrimit të udhëheqësve jo të besueshëm;

b) të reformohet sistemi arsimor dhe të ristrukturohet programi i ekuilibruar në mënyrë të pabarabartë i zhvillimit ekonomik;

c) të shqyrtohet politika e fqinjësisë së mirë e Jugosllavisë ndaj Shqipërisë;

d) të rishikohet sistemi i mbrojtjes së të gjithë njerëzve dhe vetëmbrojtjes sociale;

e) të forcohet kudo disiplina e partisë; dhe

f) të ritheksohet pozita kushtetuese e Kosovës

9. Kjo situatë çon në një detyrë të vështirë, por duket se Kosova e ka ndezur udhëheqjen me vendosmëri dhe gatishmëri për të adoptuar një qasje më realiste për shumë probleme të fshehura.

Bolland
(Përsëritet sipas kërkesës)
[Ky telegram nuk është përcjellë]

-29-

Konfidenciale
J C R Gray Esq
Ambasada britanike
Beograd
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit,
11 maj 1981
I nderuar Charles,

Kosova

1. Ju lutem referojuni letrës sime, të datës 22 prill, për misterin që rrethon zjarrin e vënë në Patriarkanën Ortodokse Serbe në Pejë.

2. Një mik i imi i cili është anëtar i Komisionit serb për Mbrojtjen e Monumenteve të Lashta, më tha se hetimi mbi shkaqet e zjarrit tashmë ishte i plotë. Pasi policia e kishte

marrë në pyetje kryemurgeshën e Patriarkanës për pesë orë, kinse në përpjekje për t'i nxjerrë asaj historinë mbi atë që kishte ndodhur, u vendos më pas se zjarri nuk ishte në të vërtetë një aksident, por ishte zjarr vënie e qëllimshme. Dy shqiptarë, babë e bir, janë ndaluar për këtë.

3. Deri më sot, asnjë fjalë nuk ka dalë në shtyp për këtë çështje. Mendoj se autoritetet po shqyrtojnë se si ta paraqesin përfshirjen e shqiptarëve në një mënyrë sa më pak të mundshme për të zgjuar serbët, zemërimi i të cilëve është zgjuar tashmë nga dhunimi i varreve serbe në Kosovë.

I Juaji,
T. J. Clark

-30-
Konfidenciale

GR 550
Fm Beograd 140826Z, maj
Direkt për FCO (DESKBY 141030Z)
Kopje origjinale
Nr. tel. 066, datë 14 maj 81
Prioritet për Moduk, Washington

Kosova: situata e sigurisë

1. Ambasada amerikane na ka dërguar një kopje të pyetjes për një person lokal kontakti i cili u dha atyre një përshkrim të detyrës të kohëve të fundit aktive të kushëririt të tij në Kosovë me shërbim rezervë privat në ushtri.
2. Dëshmia e rezervistit mbulonte periudhën e muajit deri më 7 maj. Ai ishte caktuar në një njësi këmbësorie e cila është zhvendosur në zonën e Podujevës gjatë javës së dytë të prillit. Njësia e tij ishte përfshirë në ato që ai i përshkruante si luftime në rrugë në Podujevë gjatë fundjavës 1-4 maj. Kjo njësi drejtohej nga “njësitë speciale të komandës” të cilët mbanin veshur rroba civile me jelekë kundërajrorë, të zgjedhur të gjithë sipas madhësisë dhe këto njësi mbanin edhe maska mbrojtëse. Njësia e ushtrisë së rezervistit, e udhëhequr nga këto komando, kishte pastruar disa pjesë të Podujevës shtëpi më shtëpi më 1 maj dhe kishte konfiskuar sasi të mëdha pistoletash.
3. Më 13 prill, punëtorët dhe studentët shqiptarë në Vushtrri okupuan një fabrikë tekstilësh, e cila në atë kohë ishte izoluar nga trupat, njësia e rezervistit dhe komandot speciale. Fabrika u dogj dhe u dëmtua konsiderueshëm para se të largoheshin okupuesit. Ushtarët kishin urdhër të përdornin vetëm shkopinj por kishin autoritetin të përgjigjeshin me armë nëse ndaj tyre hapej zjarr.
4. Më 5 maj, njësia e rezervistit ishte në një mision në kodrat në lindje të Vushtrrisë kur ushtarët ranë në një pritë nga një grup i armatosur shqiptarësh që përdornin armë automatikë. Pas afërsisht një ore e gjysmë, njësia e tij u lirua nga një njësi tjetër jugosllave e ushtrisë. Nga të dyja palët pati të vrarë dhe të plagosur dhe u përdorën helikopterë për evakuimin e tyre në akademinë mjekësore ushtarake në Beograd. Ndërkohë që njësia e rezervistit po kthehej në zonën e Vushtrrisë kanë një kishë ortodokse serbe e cila ishte shkatërruar plotësisht gjoja nga rebelët.
Komente
5. Nuk kemi mjete për të vërtetuar këtë dëshmi në terren. Megjithatë,

Drulović, sekretari ekzekutiv i Komitetit Qendror të Partisë, më ka thënë që forcat e armatosura nuk janë përdorur në operacione aktive kundër demonstruesve në Kosovë. Një gjeneral i lartë ka përsëritur në mbledhjen e datës 13 maj se njësitë e forcave të armatosura nuk kishin shtënë asnjë plumb gjatë trazirave në Kosovë.

6. Gjithsesi, po ju raportoj këtë dëshmi amerikane sepse mendohet që ka vlerë dhe në një farë mase, është mbështetur nga përshkrimet e shtypit mbi trazirat në Podujevë gjatë ditëve të pushimeve 1-4 maj.

Bolland

-31-

Deskby 141015Z
Fm Beograd 140808Z, maj
Direkt për FCO
Kopje origjinale
Nr. tel. 065, datë 14 maj 81
Prioritet për Moduk Washington
Telegrami im, nr. 62

Kosova

1. Sot janë publikuar konkluzionet e mbledhjes së Komitetit Qendror të Partisë, më 7 maj.
2. U tha se qëllimi i forcave armiqësore dhe kundërrevolucionare ishte që të kërcënonin integritetin dhe sovranitetin e Federatës Jugosllave dhe sistemin e saj socio-politik. Ata janë mbështetur nga forcat reaksionare jashtë Jugosllavisë.
3. Ishte e nevojshme që këto trazira të trajtoheshin efektivisht duke marrë masat aktive në vijim:
a) forcimi dhe spastrimi i lidhjes së komunistëve dhe organizatave të tjera socio-politike në të gjitha nivelet;
b) përdorim i të gjitha këtyre organizatave sociale dhe politike duke përfshirë aleancën socialiste, sindikatat dhe organizatat e rinisë;
c) luftimi i të gjitha formave të nacionalizmit: nuk do të tolerohet asnjë sulm nga grupe të tjera kombëtare kundër shqiptarëve;
d) Kosovës nuk do t'i jepet statusi i Republikës, por do të shqyrtohet me kujdes zbatimi i dispozitave ekzistuese kushtetuese për krahinën e Kosovës në kuadrin e Republikës së Serbisë;
e) do të vazhdohet të ndërmerren të gjitha hapat për të ndihmuar Kosovën ekonomikisht si pjesë e pazhvilluar e Jugosllavisë;
f) nisur nga përvoja dhe ngjarjet në Kosovë, Partia dhe publiku duhet të informohen plotësisht dhe në kohë;
g) duhet të përmirësohet sistemi arsimor, veçanërisht në universitet dhe shkollat e mesme, stafet mësimdhënëse dhe librat shkollorë;
h) duhet të forcohet sistemi i brendshëm i sigurisë me çdo ndryshim të nevojshëm të personelit, organizimit dhe pajisjeve.
4. Shtypi i sotëm ka publikuar gjithashtu një raport të një revolte tjetër studentësh në Universitetin e Prishtinës (i përshkruar si “fortesa e nacionalizmit”) gjatë natës së 12 majit kundër masave të marra në ditën e mëparshme për spastrimin e administratës dhe organizatave të studentëve në Universitet. Kanë federal është informuar dje se situata në Kosovë ka mbetur shumë e vështirë.

Bolland

-32-
Konfidenciale

A. E. Montgomery Esq
Ambasada britanike
Beograd
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit,
18 maj 1981
Inderuar Alan,

Kosova: pozita kushtetuese

1. Në telegramin tonë nr. 60 të datës 8 maj, ku përmblidhet rezultati i mbledhjeve të Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe Serbisë, përmendëm vendosmërinë për të ruajtur pozitën kushtetuese të Kosovës brenda Serbisë. Kjo, siç raportohet në telegramin tonë nr. 65 të datës 14 maj, është pasqyruar në Konkluzionet e KQ-së së LKJ-së, ku ndër të tjera thuhej se KQ i LKJ-së e konsideronte të nevojshme që “të shqyrtonte praktikën dhe problemet e arritjes së unitetit mbi bazën e ndërtimit të marrëdhënieve socialiste vetëmenaxhuese dhe nga këndvështrimi i funksioneve kushtetuese të Federatës, Serbia si Republikë dhe provincat autonome, të cilat janë pjesë përbërëse e Serbisë dhe elementë kushtetues të Federatës”. Kështu, siç parashikohet në paragrafin 14 të njoftimit të ambasadorit të datës 24 prill, ekspertët kanë sot detyrë që të rishqyrtojnë marrëdhëniet midis vetë Serbisë dhe Kosovës. Është e qartë gjithashtu nga debati publik, i cili sapo ka filluar, se kjo marrëdhënie nuk ka një përkufizim dhe se, me gjithë përpjekjet e mëparshme, askush nuk është i përgatitur për të sqaruar paqartësitë nga frika se mos hapen probleme.
2. Problemi i kthehet pikërisht themelimit të Jugosllavisë. Sipas një libri të historisë jugosllave për këtë periudhë, Organizata Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe Metohisë miratoi një rezolutë në konferencën e saj, më 31 dhjetor 1943 dhe 1 dhe 2 janar 1944, ku në parim u mbajt qëndrimi për vetëvendosje dhe u përcoll mendimi se ky parim mund të realizohej përmes bashkimit me Shqipërinë. Një gjë e tillë u kundërshtua nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Jugosllave, pikëpamja e të cilit natyrisht që mbizotëroi. Në një mbledhje të Organizatës Nacionalçlirimtare Krahinore të Kosovës dhe Metohisë, më 8-10 maj 1945, ishte vendosur që kjo Krahinë duhej të bashkohej me Serbinë me status autonom. Ajo që nuk është e qartë është se çfarë i

ndryshoi mendjet e kosovarëve, por një lloj marrëveshjeje me sa duket ishte arritur. Ka një aluzion për këtë në një vërejtje që gazeta “Zëri i Popullit” në një artikull të saj, të datës 23 prill, i bëri Titos në bisedimet e tij me Hoxhën në vitin 1946: “Kosova dhe zonat e tjera ku banojnë shqiptarë i përkasin Shqipërisë dhe do t’ua kthejmë ato por jo tani sepse reagimi i Serbisë së Madhe nuk do të pranonte gjëra të tilla”. Politikanët jugosllavë dhe shtypi nuk e kanë komentuar këtë citim të pretenduar, i cili në vetvete është interesant.
3. Profesor Najdan Pashiç, kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, nuk hodhi asnjë dritë në një intervistë së fundmi me “NIN”. Ai tha se “ekzistenca e krahinave autonome ... ishte pjesë e zgjidhjes revolucionare të çështjes kombëtare në Jugosllavi ... një zgjidhje që ishte pasojë logjike e vetë mënyrës marksiste të zgjidhjes së çështjes kombëtare në këtë vend ... për ruajtjen e integritetit territorial të Jugosllavisë, që ishte një nga vendimet revolucionare të Mbledhjes së Dytë të AVNOJ - Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar i Jugosllavisë [më 29 nëntor 1943]”. Fatkeqësisht, mbledhja e AVNOJ-së nuk e trajtoi në mënyrë specifike statusin e Kosovës por përmendi vetëm në terma të përgjithshme se i garantonte të gjitha pakicave kombëtare të gjitha të drejtat e tyre kombëtare. Pashiç vazhdoi të thoshte: “Duke pranuar parimin e barazisë kombëtare dhe të drejtën për vetëvendosje të popujve të Jugosllavisë, Jugosllavia është themeluar si një Federatë që përbëhej nga gjashtë Republika si shtete dhe dy njësi autonome, të cilat janë element përbërës i federalizmit jugosllav me të gjitha të drejtat që kjo nënkupton por janë pjesë e një Republike - Serbisë”. Ai nuk e mori parasysht pyetjen se çfarë ndodhi me të drejtën e shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje! Por ai përjashtoi çdo mundësi të tillë duke thënë: “Meqenëse Jugosllavia është krijuar mbi parimin e vetëvendosjes kombëtare, nuk mund të ketë territor jashtë numrit të Republikave ekzistuese si shtet i popujve të Jugosllavisë”. Ai refuzoi madje të pranonte se ka pasur ndonjëherë ndonjë mendim për të cilin, ai tha, kishte “arsye dhe justifikime historike, kombëtare dhe të tjera të tilla”.
4. Që prej vitit 1943, ka pasur një sërë kushtetutash federale. Kushtetuta e fundit, ajo e vitit 1974, e përcaktoi

Republikën si një shtet socialist dhe Krahinën si një komunitet socialist autonom social-politik në të cilin populli punonjësis arrin të drejtat e tij, përveç atyre që arrihen në Republikë. Kushtetuta e Serbisë rregullon marrëdhënien e kësaj të fundit, por Pashiç tha se pjesa përkatëse e saj nuk është përpunuar ende si duhet në detaj. Sipas Pashiçit, vështirësia ishte se sapo dikush të thoshte ndonjë gjë në këtë drejtim, do të gjendej menjëherë para rrezikut që mund të etiketohej si dikush që dëshironte të vinte në dyshim të drejtat kushtetuese të dikujt tjetër. Kështu, megjithëse neni 301 i Kushtetutës serbe thotë se Republika mund të fusë ligje që mbulojnë të gjithë Republikën, me kusht që të arrihen marrëveshje me Krahinat, mungesa e marrëveshjes për kompetencat e Republikës ka nënkuptuar se vetë Serbia e të gjitha republikave, nuk ka qenë në gjendje të fusë një ligj për mbrojtjen e të gjithë njerëzve, apo planin social dhe nuk ka instrumentet e nevojshme të një sistemi të bashkuar të sigurisë, statistikave dhe kombësisë. Pashiç, tha se sovraniteti i udhëheqjeve të Krahinave dhe i Republikës kanë “paralizuar procesin”.
5. Janë bërë përpjekje për ta trajtuar këtë çështje me guxim, ku rasti i fundit i përket vitit 1977. Ivan Stamboliç, kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Serbisë, tha në një mbledhje të kohëve të fundit të Komitetit Qendror të Serbisë se diskutimet në vitin 1977 kishin shkuar keq dhe nuk ishin në gjendje të jepnin një përgjigje të qartë - “Krahinat socialiste autonome nuk janë dhe nuk mund të jenë komunitete shtetërore”. Pashiç tha për këto bisedime se ishin ndërprerë menjëherë: “ato kapitulluan në një lloj oportunitizmi politik. Frika e konfrontimeve të hapura politike bëri që kjo temë të hiqej nga axhenda; çdo gjë u lejua të vazhdonte siç ishte”. Konkluzionet e këtyre diskutimeve nuk janë publikuar asnjëherë.
6. Nëse tema është mbajtur fshehur si shumë e vështirë në vitin 1977, ndërkohë që Tito ishte ende gjallë, pse sot politikanët thonë se kjo temë duhet të vendoset në axhendë, siç u shpreh Millosh Miniç në mbledhjen e fundit të KQ-së të LKJ-së “për të parë thelbin e saj dhe për të ndërmarrë zgjidhjet e saj”? Është e qartë se ata e kanë nxjerrë konkluzionin nga ngjarjet në Kosovë që mos-qartësimi i kompetencave të Krahinës është një nga shkaqet e trazirave të sotme.



Në të vërtetë, në mbledhjen e fundit të KQ të LKJ u tha se “praktika e kthimit të Krahinës pothuajse ekskluzivisht në Federatë dhe shpërfillja e komunikimit me Serbinë krijuan probleme politike”. David Miller është duke shkruar më vete për problemet e mëtejshme qe rrjedhin nga negociatat e pavarura të Kosovës për marrëveshje kulturore me Shqipërinë.

7. Megjithatë, është e vështirë të shohim nëse diskutimi i vështirë për këtë temë mund të jetë më i suksesshëm sot sesa më parë, duke marrë parasysh dallimin e gjerë midis vendosmërisë së Serbisë që Krahinat duhet të pranojnë statusin e tyre aktual kushtetues dhe së njëjtës vendosmëri (më konkretisht të Kosovës) për t’u mbajtur fort pas pavarësisë së vërtetë që ata kanë fituar në praktikë. Duhet të shtoj se Vojvodina nuk po kërkon asnjë lloj ballafaqimi në këtë çështje, por pozita e Kosovës natyrisht që është ndryshe. Në të vërtetë, nëse udhëheqja e saj do të pasqyronte pikëpamje nacionaliste-lokale, ajo do të kërkonte pavarësi edhe më të madhe. Pashiç, bëri të qartë që një diskutim i tillë nuk duhet të lejohet, duke thënë se ishte e nevojshme të lihej mënjaniçdo dyshim që nënkuptonte kërkesën për rishikimin e Kushtetutës. Një gjë e tillë do të çonte në “raskapitje dhe destabilizim”. Ai tha se çështja më tepër këtu kishte të bënte me vendosjen në axhendë të dobësive për plotësimin e kushtetutës, dhe jo vetë kushtetutën. Ai besonte se duhej bërë çdo gjë për të zbatuar kushtetutën saktësisht siç ishte shkruar - as më shumë, as më pak. Nëse, siç mund të parashikohet, udhëheqja e Kosovës pajtohet me këtë, marrëdhënia kushtetuese midis Kosovës dhe Serbisë mund të përfundojë në një përcaktim më të saktë të saj, por sipas mendimit tim, kjo nuk do të zhdukte aspiratën e kosovarëve për vetëvendosje në mënyrë më përfundimtare sesa mjetet e përdorura për shtypjen e saj në përfundim të Luftës. Ka qartazi njëfarë objektiivi për të rregulluar dhe zbatuar dispozitat aktuale të kushtetutës së Serbisë dhe asaj të Kosovës qoftë edhe vetëm për të zgjidhur çështjet e bllokua, por ekziston rreziku që gjatë procesit mund të dalin një numër çështjesh të vështira politike mbi bazën e marrëdhënies aktuale. Për këtë arsye, ekspertët kushtetues duhet të zgjedhin një rrugë shumë të vështirë midis zonave të minuara nacionaliste.

8. Unë dhe ambasadori do t’i bëjmë një vizitë të shkurtër Pashiçit, më 21 maj, dhe do të përpiqemi ta nxisim atë flasë për këtë temë të ndërlikuar dhe delikate.

I Juaji, T. J. Clark
Për dijeni: P. Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit

**-33-
Konfidenciale**
A. E. Montgomery Esq
Ambasada britanike
Beograd
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit,
18 maj 1981
I nderuar Alan,

Kosova: situata e sigurisë
1. Çdo vit 13 maji festohet këtu si

“Dita e Sigurisë”, ku forcat e sigurisë nën Sekretariatin Federativ të Punëve të Brendshme nderohen zakonisht se kanë mbrojtur me sukses sigurinë e brendshme të kombit gjatë vitit të kaluar. Me këtë rast këtë vit, Franjo Herljeviç dha një intervistë për “Tanjug”, ku hodhi më shumë dritë mbi ngjarjet në Kosovë.

2. Ai filloi të theksonte faktin se udhëheqja në Federatë, Republikat dhe Krahinat kishin dhënë vlerësime “kompetente” për situatën e sigurisë në vend. Së paku në lidhje me Kosovën, kjo deklaratë u besua nga dëshmia e tij e mëvonshme e detajuar mbi një seri incidentesh që çuan në ngjarjet e fundit, ku udhëheqja e Kosovës qartazi nuk e vlerësoi situatën “me kompetencë”.

3. Herljeviç pohoi se që nga mesi i vitit 1980, d.m.th. periodha post-Tito, armiku ishte bërë gjithnjë e më agresiv dhe më i rrezikshëm. Ai renditi grupe të ndryshme armiqësore aktivitetet e të cilave ishin zbuluar gjatë viteve të fundit, të tilla si: “nacionalistët, një pjesë reaksionare e klerit, dhe patronët e liberalizmit dhe anarko-liberalizmit”, të cilët kërkonin një lloj “shoqërie borgjeze, multi-partiake”, dhe të cilët janë angazhuar në shpërndarjen e broshurave dhe fletushkave, kanë organizuar tubime të ndryshme, kanë publikuar intervista dhe artikuj me karakter armiqësor në shtypin e huaj dhe atë të emigrantëve; “informbyroistët” që veprojnë nga pozita “burokratike-dogmatike”; “organizatat fashiste të emigrantëve”, të cilat kanë rritur veprimtarinë e tyre antijugosllave, veçanërisht në lidhje me Kosovën, ku një numër i caktuar elementësh “proustashë, proçetnikë, ballistë, zogistë dhe irredentistë” janë përfshirë në vend; si dhe “Partia e re Komuniste e Jugosllavisë”, udhëheqja e së cilës ishte “shkatërruar”. Ai theksoi se në disa vende perëndimore ishin marrë masa policore kundër organizatave fashiste e terroriste të emigrantëve. Megjithatë, ai shtoi një pikë që duhet mbajtur mend për vizitën e Vrhovec: “ne presim me të drejtë nga këto vende më shumë efikasitet në këtë nivel, që është detyrimi i tyre ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar dhe të gjitha formave të dhunës”.

4. Sidoqoftë, pjesa kryesore e intervistës iu kushtua Kosovës. Ajo ishte e jashtëzakonshme në dy aspekte. Së pari, Herljeviç nuk iu referua vetëm një herë organizatorëve kryesorë të të ashtuquajturit kundërrevolucion të quajtur nga Mojsov në mbledhjen e fundit të KQ-së së LKJ-së - “Partia Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi”. Së dyti, efektivisht ai ka hedhur poshtë argumentin se kosovarët ishin zënë në befasi nga ngjarjet duke dhënë detaje të aksionit të sigurisë kundër elementëve armiqësor në Kosovë gjatë muajve të mëparshëm, dhe, në të vërtetë, gjatë viteve të mëparshme.

5. Herljeviç tha se gjatë viteve të fundit ishte rritur aktiviteti në mbështetje të nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar dhe Partisë së Punës së Shqipërisë (PPSH). Pas demonstratave të vitit 1968, fushatat e para të mëdha të propagandës u zhvilluan në vitin 1973 dhe 1974. Me rastin e 100-



vjetorit të Lidhjes së Prizrenit në vitin 1978, u shpërndanë fletushka në Prishtinë dhe vende të tjera të Kosovës në mbështetje të PPSH-së dhe iu bë thirrje shqiptarëve “të luftojnë për liri dhe të bashkohen me Shqipërinë”. Në vitin 1979, një aktivitet të tillë të ngjashëm ka pasur në shtatë qytete të Kosovës. Në vitin 1980, ishin regjistruar disa raste të parullave irredentiste të shkruara në vende publike; gjithashtu ishte asgjësuar një fushatë në shkallë të gjerë propagandistike nga forcat e sigurisë në nëntor, të cilat kishin kapur disa mijëra fletushka, mbi 1,000 gazeta dhe qindra libra të futura nga anëtarë të organizatës proshqiptare “Fronti i Kuq”. Së fundi, në fund të shkurtit 1981, ishin shkruar parulla përsëri në vende të ndryshme të Kosovës. Në kundërpërgjigje, forcat e sigurisë kishin marrë masat e duhura. Për shembull, Herljeviç citoi se në vitin 1974 ishte zbuluar një grup irredentist dhe në vitin pasardhës ishte zbuluar aktiviteti i një organizate tjetër. Në vitin 1979 dhe 1980 ishin zbuluar pesë grupe në Prishtinë dhe Ferizaj. Në fund të vitit 1980 dhe në fillim të vitit 1981 ishte zbuluar një grup tjetër që i përkiste “Frontit të Kuq”. Gjithashtu, në periudhën midis viteve 1978 dhe 1980 ishin shkatërruar dy grupe në Maqedoni; njëri grup ishte i lidhur me Kosovën dhe grupi tjetër me Shërbimin e Fshehtë Shqiptar dhe emigrantët fashistë shqiptarë (ai nuk e përmendi, por shtypi raportoi më 14 maj se pesë shqiptarë do të gjykohen në Shkup për aktivitet armiqësor në periudhën midis qershorit 1979 dhe shkurtit 1981 në Tetovë, Gostivar dhe zonat përreth, përfshirë organizimin e Partisë Kombëtare të Punës). Kështu, në periudhën midis 1974-1981 forcat e sigurisë në Kosovë kishin identifikuar mbi 600 veta si persona që kanë vepruar në një mënyrë pak a shumë të organizuar në mbështetje të pozitive nacionaliste/irredentiste nga të cilët 89 persona ishin dënua për vepra penale dhe 40 të tillë për vepra të vogla; dhe një numër tjetër prej 503 vetash ishin akuzuar se kishin mbështetur publikisht nacionalizmin/irredentizmin.

6. Herljeviç u ndal më tej në çështjen e “Frontit të Kuq”, duke e bërë të qartë me lejen e Mojsov, se ky front ishte një nga organizatorët më aktivë të aktivitetit armiqësor në Kosovë. (Nëse ka vlerë të thuhet,

kolegu im rumun më tha se një anëtar i Sekretariatit të Heljeviç i kishte thënë atij që nuk kishte dëgjuar asnjëherë për PKMLSHJ!). Ai tha se kjo organizatë operonte nga disa vende perëndimore dhe mbështeste PPSH-në. Ajo përfshinte “disa dhjetëra nga qytetarët tanë me origjinë shqiptare të cilët janë duke punuar përkohësisht jashtë vendit”. Disa anëtarë ishin të lidhur me Shërbimin e Fshehtë Shqiptar dhe vepronin sipas udhëzimeve nga Shqipëria të cilat, së bashku me materialet propagandistike, ata i merrnin përmes kanaleve diplomatike/konsullore shqiptare dhe zyrave të tjera përfaqësuese, të ashtuquajturat grupe marksiste-leniniste dhe kanale të tjera. Qendrat kryesore të organizatës “Fronti i Kuq” ishin të njohura; dhe kjo organizatë ishte e lidhur me emigrantët fashistë shqiptarë në Evropën Perëndimore dhe gjetkë (mund të shtoj se kolegu im zviceran më tha në konfidencë se qytetari zviceran i cili paraqiti kërkesën për demonstratën e fundit në Cyrih njihej se punonte për Shqipërinë).

7. Herljeviç u pyet më pas nëse në këtë situatë forcat e sigurisë ishin zënë në befasi. Ai e kuptoi që informacioni i mëparshëm tregonte se ata kishin “dijeni të sigurt dhe kishin marrë masat kundër njerëzve në fjalë”. Megjithatë, ai shtoi: “fatkeqësisht, individët në Kosovë nuk nxorën konkluzionet e duhura dhe nuk morën masat e nevojshme. Për më tepër, ka pasur amulli në forcimin dhe përgatitjen e vetë-mbrojtjes sociale, duke përfshirë forcat e sigurisë në Kosovë” (ishte zbuluar në mbledhjen e KQ-së së LKJ-së nga sekretari kosovar i Punëve të Brendshme, se milicia kishte forca të pamjaftueshme me vetëm një milic për 789 qytetarë, krahasuar me raportin 1:545 që ishte mesatarja në shkallë kombëtare).

8. Herljeviç e mbylli me pak fjalë duke folur për maturinë me të cilin ishin prirur të vepronin forcat e sigurisë (duke harruar trajtimin e ashpër të demonstruesve më 26 mars). Ai pohoi se shumicës së njerëzve të përfshirë në incidentet e mëparshme thjesht u ishte folur për t’u thënë se ishin në rrugë të gabuar. Në vetë ngjarjet, forcat e sigurisë kishin vepruar “në mënyrë humane dhe të disiplinuar dhe nuk kishin

përdorur forcën me përjashtim të rasteve ekstreme”. Ai tha se kjo konfirmohej nga numri i të plagosurve që pësuan forcat e sigurisë. Ai përmendi gjithashtu se forcat e sigurisë vinin nga e gjithë Jugosllavia dhe nuk ishin vetëm “milicë serbë”, siç pretendonin disa, dhe se nuk ishte përdorur asnjë ushtar i vetëm për rivendosjen e rendit.

Komente

9. Kjo ishte deklarata më e hollësishme që mbaj mend nga Herljeviç apo ndokush tjetër e cila është bërë në lidhje me çështje të sigurisë dhe për këtë arsye është një shembull tjetër se si autoritetet po përkulen para presionit për t’i ofruar publikut më shumë informacion në dispozion. Megjithatë, një tablo e plotë e ngjarjeve në Kosovë mbetet e paplotë. Kjo situatë të lë përshtypjen akoma më të fortë të naivitetit, vetëkënaqësisë ose të marrëveshjes së fshehtë nga ana e autoriteteve politike në Kosovë për të shpjeguar dështimin e tyre për t’iu përgjigjur shenjave paralajmëruese të pranishme prej kohësh të trazirave të pashmangshme. Po kështu, është e qartë se autoritetet qendrore të sigurisë duhen fajësuar njësoj që nuk nxorën konkluzionet e duhura për krijimin e aktivitetit nationalist shqiptar gjatë viteve të fundit. Ose, ndoshta këtë e bënë dhe autoritetet politike qendrore refuzuan që të vepronin nga frika se mos trazonin kosovarët dhe akuzoheshin për ndërhyrje, siç edhe ndodhi në kontekstin më të gjerë të marrëdhënieve midis Federatës, Serbisë dhe Kosovës. Më shumë të dhëna në këtë drejtim mund të zbulohen ende në të ardhmen.

10. Sidoqoftë, një gjë po bëhet akoma më e qartë: askush deri më sot nuk e ka mbështetur pretendimin e Mojsov se PKMLSHJ-ja ishte përgjegjëse për organizimin e demonstratave. Hamendja ime është se ky emër mund të jetë përdorur në fletushkat që kanë qarkulluar në Kosovë dhe se, në lidhje me organizimin e ngjarjeve, ka më shumë të ngjarë që të jetë përfshirë “Fronti i Kuq”.

I Juaji,
T. C. Clark

Për dijeni: P. Rennie Esq; P. Rosling Esq
Departamenti i Kërkimit, Zagreb



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Fitore bindëse për Besa Famgasin e Kastriotin

PEJË, 24 MARS - Nuk kanë ofruar shumë rivalitet dy ndeshjet e së dielës, që ishin të vlefshme për xhiron e 22-të të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Kampionia aktuale, Besa Famgas e mposhti në Pejë skuadrën e Vushtrrisë me

rezultat 38:21. Jon Vokshi u shqua te skuadra pejane me plot 14 gola. Arbios Mushkolaj i kishte gjashtë e Antonio Vozila pesë. Shtatë gola për Vushtrrinë i shënoi Fitim Klinaku. Nga katër i kishin Egzon Ademi e Amir Fazliu. Besa është e dyta me 36 pikë.

Vushtrria është e gjashta me shtatë pikë. Ndërkohë Kastrioti ka mposhtur Trepçën në Mitrovicë me rezultat 50:28 dhe doli në pozitën e tretë me 28 pikë. Trepça mbetet me 26 pikë dhe ka rënë në pozitën e katërt. Skuadra mitrovicase e ka një ndeshje më pak të

luajtur. Trepça ka mbetur me fond të limituar lojtarësh dhe nuk ia doli të rivalizoi ferizajasit e mobilizuar. Rron Ramadani i shënoi 11 gola për Kastriotin. Nga gjashtë i kishin Festim Mustafa, Marley Wallace e Deniz Terziqi. Yassine Henahen i shënoi tetë



gola për mitrovicasit. Nga gjashtë i kishin Amar Mujka, Sali Maxhera e Shpëtim Mehmeti.

Ylli me fitore të rëndësishme në Prizren, Vëllaznimi rikthehet në vendin e pestë

"Epoka e re"

PRIZREN, 24 MARS - Golden Eagle Ylli ka shënuar fitore shumë të vlefshme, duke mundur Proton Cable Prizrenin me rezultat 63:96 (16:28, 13:25, 19:22, 15:21), në javën e 27-të të Prince Caffë Superligës. Ndeshja faktikisht është vendosur në pjesën e parë, ku mysafirët që duan pozitën e dytë në renditje, ishin më të motivuar, duke qenë më të mirë në çerekun e parë dhe të dytë, për të shkuar në pushim me rezultat 29:53. Në pjesën e dytë therandasit ruajtën epërsinë dhe madje e thelluan për të fituar 63:96. Isaiah Kelly kishte 17 pikë e 13 kërcime për vendasit, derisa Alonzo Verge Jr 25 pikë, pesë kërcime e katër asistime. Proton

Cable Prizreni mbetet në vendin e shtatë me shtatë fitore e 20 humbje, kurse Golden Eagle Ylli barazohet me pikë me Pejën, nga 18 fitore e nëntë humbje. Vëllaznimi ka shënuar fitore ndaj Istogut me rezultat 97:68 (23:13, 23:14, 26:23, 25:18), në javën e 27-të të Prince Caffë Superligës, duke u rikthyer në vendin e pestë. Ashtu si ishte pritur, kuqezinjtë ishin më shumë të motivuar dhe para publikut vendas u rikthyen te fitorja, ku ishin më të mirë nga fillimi se istogasit për të triumfuar me rezultat 97:68. Daniel Lekndreaj ishte më i miri te vendasit me 31 pikë, 17 kërcime e pesë asistime, derisa Donat Rexhepi shënoi 20 pikë për mysafirët. Vëllaznimi ka 12 fitore e 15 humbje, kurse Istogu

një fitore e 26 humbje. Të shtunën Sigal Prishtina ka triumfuar në derbin ndaj rivalit të vjetër, Pejës me rezultat 88:98 (16:25, 18:25, 25:23, 29:25). Kwame Vaughn ishte më i miri te Peja me 22 pikë, tri kërcime dhe katër asistime, derisa te Sigal Prishtina u dalluan Derrick Wilson me 23 pikë, katër kërcime e dhjetë asistime dhe Diamond Stone me 25 pikë, nëntë kërcime e katër asistime. Trepça po vazhdon me fitore në Prince Caffë Superligë, ku në xhiron e 27-të mundi Bashkimin 92:78 (37:23, 9:25, 23:13, 23:17), që ishte e 20-ta radhazi në elitë. Te vendasit më i miri ishte Drilon Hajrizi me 27 pikë e shtatë kërcime, kurse Isiah Umipig shënoi 22 pikë për mysafirët.



Kosova zhvilloi stërvitjen e parë në Budapest

BUDAPEST, 24 MARS - Nën drejtimin e përgjdhësit Franco Foda, Kombëtarja e Kosovës ka vazhduar punën me fokus te miqësorja e radhës kundër Hungarisë, që zhvillohet të martën, në orën 19:00, në stadiumin "Puskas Arena" në Budapest. Stërvitja e parë në kryeqytetin hungarez ka qenë një mundësi e mirë për ekipin për të hartuar strategjitë dhe taktikat e lojës për të përballuar me sukses sfidën ndaj një kundërshtari të fortë. Ndeshja me Hungarinë pa dyshim do të jetë një test i vështirë

për "Dardanët", por ata janë të vendosur që në stadiumin e stërmbyshur me tifozë të japin më të mirën e tyre. Pas stërvitjes futbollistët Lindon Emërllahu dhe Blendi Idrizi kanë shprehur besimin e tyre në ekip dhe në aftësitë e tyre për të luajtur një ndeshje të mirë. Ata besojnë se me përgatitjen e mirë nga stafi teknik, do të arrijnë në rezultat të favorshëm. "Dardanët" sot (e hënë) në orën 17:00 do ta zhvillojnë stërvitjen e radhës dhe të fundit për këtë grumbullim në stadiumin "Puskas Arena".

Shqipëria sonte zhvillon miqësore ndaj Suedisë

STOKHOLM, 24 MARS - Kombëtarja e Shqipërisë sonte nga ora 19:00 do të zhvillojnë në stadiumin "Friends Arena" të Stokholmit, testin e dytë zyrtar para fazës së grupeve, të Kampionatit Evropian të futbollit, "Euro 2024", teksa si kundërshtar do të kenë

Kombëtarën e Suedisë, me "Vikingët", që ka jo pak emër në futbollin botëror. Pas përfundimit të konferencës zyrtare për media të trajnerit Silvinjo dhe mesfushorit Ylber Ramadani, skuadra zbriti në fushën e lojës dhe kreu seancën stërvitore në

stadiumin "Friends Arena", duke mbyllur kështu edhe përgatitjet për duelin miqësor ndaj Suedisë, stërvitje që zgjati më shumë se një orë në stadiumin e ndeshjes. Skuadra ka punuar më shumë me topin, pa ngarkesa fizike dhe gjendja e lojtarëve është e mirë. I

gjithë fokusi është vetëm te sfida e dytë miqësore e marsit ndaj Suedisë. Ndërkaq, kujtojmë se kjo është një përballje shumë e rëndësishme për "Legionarët" tanë, që kërkojnë të hedhin "pas krahëve", humbjen katastrofike 0 me 3, ndaj Kilit.





ROYAL CROWN;
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

